

Fjalimi i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi

Ndjehem sinqerisht e nderuar dhe e privilegjuar që të hapë në praninë tuaj, ceremoninë e shënimit të Vitit të 9-të Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në emër të gjyqtarëve dhe të gjithë zyrtarëve të Gjykatës Kushtetuese, fillimisht falënderoj për pjesëmarrjen në këtë ceremoni përfaqësuesit e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe diplomatët e akredituar në vend, ndërsa në veçanti përshëndes kryetarin e Komisionit të Venecias dhe njërin ndër folësit kryesorë në këtë ceremoni, z. Gianni Buquicchio. Një falënderim dhe mirënjohje të veçantë kam për delegacionet e gjykatave nga rajoni dhe më larg që na përkrahin sot me praninë e tyre në këtë ceremoni.

Prezenca e të gjithë juve në këtë përvjetor të Gjykatës, përveç se nderon institucionin tonë, njëherësh simbolizon bashkëpunimin e shkëlqyer, i cili përveç se mundëson shkëmbimin e ndërsjellë të përvojave, kontribuon edhe në përmirësimin e cilësisë së punës dhe të vendimmarrjes tonë, gjë që ndikon në përmbushjen e misionit të përbashkët që kemi në mbështetjen e sundimit të ligjit dhe promovimin e së drejtës.

Të nderuar mysafirë,

Ky vit ishte vit i sprovave ndër më seriozet me të cilat Gjykata Kushtetuese është përballur në aspektin funksional, që nga themelimi i saj. Për herë të parë, Gjykata iu nënshtrua procesit të zëvendësimit të njëkohshëm të pesë gjyqtarëve kushtetues dhe për herë të parë Gjykata më nuk ka në përbërjen e saj gjyqtarë ndërkombëtarë.

Kontributi i gjyqtarëve të larguar së fundi, që njëherësh ishin pjesë e brezit të parë të gjyqtarëve kushtetues në Republikën e Kosovës, ishte thelbësor dhe tejet i çmuar për vendosjen e themeleve të gjyqësisë kushtetuese në vend, si dhe për zhvillimin institucional të Gjykatës Kushtetuese.

Teksa ne po shënojmë sot përfundimin e Vitit të 9-të Gjyqësor, shfrytëzoj rastin që nga kjo foltore, në emrin tim, të gjyqtarëve dhe të të gjithë zyrtarëve të Gjykatës Kushtetuese, t'i falënderoj nga zemra gjyqtarët e larguar për punën e bërë, ndërsa praktika ligjore e Gjykatës sot do të ishte dukshëm më e zbehtë pa kontributin dhe pa vendimmarrjen e tyre profesionale. Tani, të gjithë ne, në kompozicionin e ri, na pret një punë edhe më sfiduese në ruajtjen dhe në avancimin e standardeve të vendosura dhe në zhvillimin e jurisprudencës bashkëkohore të Gjykatës.

Zonja e zotërinj,

Këtë vit ne shënuam dy përvjetorë me rëndësi: Dhjetëvjetorin e Pavarësisë së vendit, i cili çdo ditë e më shumë po zë vendin e merituar në familjen e shteteve evropiane, dhe Dhjetëvjetorin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si akti themeltar i shtetësisë së vendit tonë, që në vete ngërthen edhe parimet më universale të të drejtave të njeriut.

Përvjetorët jubilarë, para së gjithash, shërbejnë si momente reflektimi e vlerësimi për të arriturat e shënuara, por edhe për ngecjet e përjetuara gjatë rrugëtimit drejt më të

mirës dhe suksesit. E, duke shikuar pas në vite, rruga që kemi përshkuar dhe vështirësitë që kemi tejkaluar, na bëjnë të ndihemi krenar me progresin e arritur.

Natyrshëm, si edhe në çdo shtet tjetër dhe shoqëri në zhvillim, lufta kundër krimit e korrupsionit, mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, janë dhe do të vazhdojnë të mbeten sfida të vazhdueshme me të cilat të gjithë ne do të përballemi edhe në të ardhmen.

Përballja me këto sfida bëhet më e lehtë vetëm nëpërmjet reformave domethënëse ligjore dhe duke respektuar e zbatuar Kushtetutën tonë, dispozitat e së cilës garantojnë sundimin e pakompromis të ligjit, barazinë e të gjithë qytetarëve pa dallim dhe zhvillimin demokratik të vendit.

Në këtë prizëm duhet parë edhe rolin e Gjykatës Kushtetuese, e cila nëpërmjet vendimeve të saj do të vazhdojë të shërbejë me zell si autoriteti përfundimtar për garantimin dhe për respektimin e rendit kushtetues në vend.

Të nderuar të pranishëm,

Me vendimet e tyre, gjykatat kushtetuese kanë ndikim thelbësor në kualitetin e jetës të çdo vendi, duke formësuar konturat e qeverisjes demokratike dhe vlerat që e karakterizojnë atë.

Në këtë frymë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vazhdon të ushtrojë me besnikëri rolin dhe detyrën e saj që buron nga Kushtetuta, përderisa edhe besimi i qytetarëve në vendimmarrjen e Gjykatës është rritur dukshëm me kalimin e kohës.

Këtë e dëshmon, para së gjithash, numri në rritje i kërkesave të parashtruara nga të gjithë qytetarët në vend, përfshirë edhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, si dhe numri në rritje i vendimeve të nxjerra.

Për shumë prej këtyre vendimeve, gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës u konsultuan dhe morën parasysh edhe shembujt e praktikës gjyqësore të gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera evropiane, nëpërmjet kërkesave të parashtruara në Forumin e Komisionit të Venecias dhe aplikimit rigoroz të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në secilin vendim të Gjykatës.

Analizat e tilla krahasimtare, të përvojave dhe të vendimeve të gjykatave kushtetuese me standarde evropiane të gjyqësisë kushtetuese, tashmë janë bërë pjesë e pandashme e vendimmarrjes sonë.

Por, siç është rasti edhe me vendimet e gjykatave kushtetuese në vendet me demokraci të zhvilluar, jo të gjitha vendimet e Gjykatës u mirëpritën në opinion, duke nxitur reagime të ndryshme edhe në media.

Liria e shprehjes së pakënaqësisë ndaj vendimeve të gjykatave dhe ndaj punës së institucioneve shtetërore, si edhe vendimmarrja e pavarur institucionale, qëndrojnë në themelet e çdo shoqërie moderne dhe janë dëshmi e emancipimit shoqëror të një vendi.

Zonja e zotërinj,

Për të ruajtur nivelin e besueshmërisë institucionale, si dhe kualitetin e punës në vendimmarrje, janë tri objektiva në të cilat Gjykata Kushtetuese ka fokusuar vëmendjen gjatë këtij viti gjyqësor:

- Integrimi i gjyqtarëve të rinj;
- Ngritja e kapaciteteve për sfidat e së ardhmes;
- Transparenca në punë.

Integrimi i gjyqtarëve të rinj kushtetues, të cilët vijnë me karrierë dhe me përvoja të ndryshme profesionale, paraqet një sfidë në vete për çdo gjykatë kushtetuese.

Përderisa injektimi i energjive dhe i ideve të reja është më se i mirëpritur dhe i domosdoshëm për çdo institucion, sfidë serioze mbetet akomodimi i tyre më i shpejtë dhe njohja me jurisprudencën e Gjykatës. Falë përvojës së gjyqtarëve më të vjetër dhe praktikave të mirëvendosura, realizimi i këtij objektivi në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës është bërë më lehtë i realizueshëm për pesë gjyqtarët e emëruar së fundi – të cilët i uroj edhe një herë para jush për marrjen e detyrës dhe ju dëshiroj sukses në përmbushjen e përgjegjësisë të reja.

Ne tashmë kemi filluar edhe me zbatimin e Planit të Tretë Strategjik të Gjykatës (për periudhën trevjeçare 2018-2020), të hartuar me përkrahjen e Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (GIZ), ku janë shpalosur ide të reja në përputhje me kërkesat e kohës dhe duke reflektuar mbi sfidat e përballura gjatë zbatimit të dy planeve strategjike paraprake. Për secilin qëllim strategjik dhe objektiv, janë parashikuar masa dhe aksione konkrete për realizimin e tyre, si dhe kritere rigoroze të vlerësimit të rezultateve.

Ndërkaq, trajnimet në lëmin e drejtësisë kushtetuese, pjesëmarrja në seminare ndërkombëtare dhe aktivitete tjera profesionale, si dhe përdorimi i teknologjisë së avancuar për menaxhimin dhe për procedimin më efektiv të lëndëve, janë vetëm disa prej aktiviteteve të planifikuara në mbështetje të avancimit të kapaciteteve të Gjykatës, me qëllim të reduktimit të afateve për shqyrtimin e lëndëve.

E për rritjen e nivelit të transparencës dhe të komunikimit më të mirë me publikun, falë ndihmës së njërit prej donatorëve dhe mbështetësve kryesorë të punës sonë, Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), këtë fillimvit ne kemi lansuar edhe ueb-faqen e re zyrtare të Gjykatës, e cila përveç mundësisë së kërkimit më të avancuar të lëndëve, ofron edhe mundësinë e abonimit të drejtpërdrejtë në buletinet e praktikës ligjore, në buletinet informative, si dhe në vendimet e fundit të publikuara.

Dëshiroj të theksoj se pa përkrahjen dhe pa mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, të arriturat dhe sukseset në punën e Gjykatës Kushtetuese, e rrjedhimisht edhe në sundimin efektiv të rendit dhe të ligjit në vend, do të ishin dukshëm më të mangëta.

Të nderuar mysafirë,

Viteve të fundit e gjithë bota po përjeton kohë të trazuara dhe sfiduese për vlerat dhe për parimet themelore të demokracisë.

Të gjithë jemi dëshmitarë të rasteve, së fundi edhe në disa vende evropiane me traditë të gjatë shtetformuese, ku qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike kanë filluar të sprovonë gjithnjë e më shumë pavarësinë vendimmarrëse dhe administrative të institucioneve të pavarura me kushtetutë, e veçanërisht të gjyqësorit.

Edhe pse Republika e Kosovës, për fatin tonë të mirë, nuk është bërë pjesë e këtij trendi negativ, duhet pasur parasysh faktin se asnjë vend nuk mund të jetë imun në këtë aspekt.

Tani, më shumë se kurrë pushteti gjyqësor duhet të shërbejë si gardian i respektimit të ligjshmërisë në vend dhe më shumë se kurrë nevojitet bashkëpunim i ngushtë i tri pushteteve për demokraci të mirëfilltë.

Kjo arrihet vetëm nëse secili nga ushtruesit e përgjegjësive në pushtetet e ndara përmbush detyrat dhe obligimet e veta kushtetuese e, para së gjithash, me gjyqtarë dhe me gjykata sovraane në punën e tyre. Dispozitat kushtetuese që përkufizojnë shtetin dhe që parashohin ndarjen e pushtetit, në mënyrë të qartë përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për secilin bartës dhe vetëm respektimi strikt i tyre mund të përmbushë misionin e Kushtetutës dhe vlerat e saj evropiane.

Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese e Kosovës tanimë ka kaluar me sukses testet e qëndrueshmërisë dhe të pavarësisë institucionale, duke ushtruar e pavarur përgjegjësitë e saj edhe në periudhat më sfiduese për organizimin shtetëror në vend.

Këtë pavarësi, Gjykata Kushtetuese e ka arritur mbi të gjitha falë punës së devotshme dhe profesionale të gjyqtarëve, të cilët në misionin e tyre për ruajtjen e rendit kushtetues, për pishtar kanë pasur dhe do ta kenë gjithnjë Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe praktikën ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Por, një gjykatë kushtetuese mund t'i mbijetojë kohës si e pavarur dhe e suksesshme vetëm me funksionimin e pavarur dhe të suksesshëm edhe të gjykatave të rregullta dhe vetëm kjo simbiozë garanton qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e demokracisë kushtetuese në vend.